

VENDIM
Nr. 812, datë 16.12.2019

PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË FINANCIAR TË MITURËS KLEJSA GREKU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar, mujor, të miturës Klejsa Greku, për periudhën deri në mbushjen e moshës 18 vjeç, në masën e dyfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama